

NORBERT JOKL

DISA FJALË TË SHQIPES SI DËSHMI TË HISTORISË  
SË KULTURËS SHQIPTARE

Ky studim u gjet prej meje e prej Prof. A. Kostallarit ndër dorëshkrimet e albanistit të shquar Prof. Norbert Joklit, që ruhen në Sekcionin e Dorëshkrimeve të Bibliotekës Nacionale të Vjenës. Studimi, që ka signaturën Series Nova 11.860, është hartuar në kohën midis viteve 1934 e 1937, sikundër del nga citimi i veprave botuar gjatë asaj kohe. Shkruar në formën e zakonshme të trajtimit monografik, ky studim, me gjithë shkurtësinë e tij, paraqitet me rëndësi të madhe për nga ana e metodës dhe përbën njëkohësisht dhe një kontribut të vlefshëm për historinë e leksikut të shqipes.

E. Ç.

Vjete më parë kam pasur rast të vë në dukje që perioda e parë e studimeve gjuhësore të shqipes, e cila karakterizohet me emrat *Miklosich*, *Schuchardt* e *Gustav Meyer*, u nis më fort nga shqyrtimi i huazimeve dhe andej mori edhe drejtimin që ndoqi. Me gjith'atë vetë Schuchardti ka qenë ai që përpara dy brezave vuri re se ky drejtim studimesh ka një rëndësi vetëm relative, se është i kushtëzuar me rrethanat e kohës, se është në vartësi të gjendjes së atëhershme të njohimeve albanologjike. "Kur të vijë dita që shqipes t'i jetë caktuar një vend i ngulët e i qëndrueshëm brenda indoeuropianishtes, atëhere ne pas gjase disa fjalë, të cilat sot, e me plot të drejtë, i marrim për huazime, do të detyrohem t'ja kthejmë prapë asaj gjuhe, si pasuri të lashtë të fondit të trashëguar", kështu shkruante Schuchardti më 1872. Që kjo profeci u përmbush e u realizua me brezin e mëpastajmë të dijetarëve, veprimtarinë e të cilëve e nisi Holger Pedersen, këtë jam përpjekur ta tregoj në veprën "Historia e gjuhësisë indoeuropiane" (botuar prej W. Streitbergut) II/2, f. 134v. Këtu më poshtë dua të sjell tani disa shembuj të tjerë që vërtetojnë profecinë e Schuchardtit, shembuj që njëkohësisht dëshmojnë se të kthyerit e atyre elementeve që merreshin më parë si të burimit të huaj, prapë të leksiku i trashëguar i shqipes, nuk varet vetëm, si theksonte Schuchardti, nga pozita që i cakton shqipes gjuhësia përbrenda rrethit të gjuhëve indoeuropiane, po varet dhe nga njohja më e saktë e leksikut, e nuancave të kuptimit të fjalëve, e frazeologjisë, e jo më pak edhe nga të pasurit parasysh të fakteve të folklorit.

## I.

Këtë fjalë të rëndësishme të kulturës dhe të jetës së përditshme: **këpucë**, G. Meyeri (Fjalori etimologjik 188) e merr për një huazim nga turq. *papush*, *papuç* "pantofël". Ky mendim ndërkaq, i cili me vështrimin e parë paraqitet si bindës, në të vërtetë na del i padrejtë, po të kemi parasysh faktet gjuhësore që kanë dalë në dritë në këto kohët e fundit.

Pranë **këpucë**-s ekziston një **k(ë)putë** "çorapja që mbështjell shpëtën e kurrizin e këmbës, gjurmashkë", që mungon nëpër fjalorë, po që e dëshmon

Baron F. Nopcsa (+) për Keimend (Albanien, Bauten, Trachten und Geräte Nordalbaniens, 1925, f. 169) dhe e përshkruan si një çorape që — në kundërshtim me çorapen e gjatë (*çorap*) që tërhiqet e zgjatet — nuk tërhiqet, arrin gjer te syri i këmbës dhe ka një ilik që mbërthehet me anë të një kopse o të një grepi. Një vërtetim të kësaj të dhëne të Nopcsës na e jep P. Gj. Fishta në një episodë të re të Lahutës së Malcisë: Zana e Vizitorit, ku përdoret shprehja *me nisë kputat* (Hylli i Dritës 10, 1934, f. 169) me kuptimin "me thurë çarapet". Si formë paralele të *k(ë)putë-s* që ka Këlmendi, Nopcsa për Shalë në vendin e cituar të veprës së tij etnografike me rëndësi jep trajtën *shputë*. Këtë fjalë e kanë edhe fjalorët, dhe e japin si me kuptimin "çarape e shkurtër, gjurmashkë" që ka dhe Nopcsa, si dhe me kuptimin "shuall, shuall i çarapes". Me kuptimet "çarape e shkurtër, gjurmashkë, shuall i çarapes" fjala na del që te Rossi, Vocab. epir-ital. 1876, f. 1199, 2, prej nga e mori dhe Meyeri (Fjal. et. f. 415), i cili ndërkaq përkthimin e Rossit "çarape e shkurtër, shuall i çarapes (pedule, quella parte della calza, che calza il piè) me një mënyrë të maazgët e dha me "shuall i këmbës". Kjo shihet qartë se ka lidhje me spjegimin — e papranueshëm, si do të tregohet këtu më poshtë — të *shputë-s* nga serbokr. *stopa* "këmbë, gjurmë" = slloven. *stopa* "shuall i këmbës". Ndër burimet e tjera *shputë-n* e kanë dhe Junku, Bashkimi, Leotti, Godini (kjo e fundit të fjalë *Socke* "çarape e shkurtër"). Nga tekstet që e përdorin *shputë-n* me kuptimin e shuallit, do përmendur p.sh. sidomos Zef Harapi (Hylli i Dritës 8, 1932, f. 52). Sipas këtij autori fjala është e Mirditës. Fakti semantik që shohim te grupi *këpucë, këputë, shputë* e te lidhja që kanë këto në mes të tyre, d.m.th. që e njëjta fjalë ose që fjalë të së njëjtës familje leksikore përmbajnë në vetvete dhe kuptimin "këpucë" dhe kuptimin "çarape e shkurtër" ("shuall i çarapes, gjurmashkë", "shuall i këmbës"), kjo gjë na vërtetohet dhe me të tjera gjuhë: gjerm. e lartë e vjetër *soc* "këpucë" edhe "çarape", rum. *călțun* "gjysmëçizme; këpucë, çarape", lat. *calceus* = këpucë, po it. *calza* "çarape". Për të spjeguar raportin midis *shputë* e *këputë* duan vënë në pah ndërkaq dhe disa fakte të tjera: 1) *shputë* do të thotë edhe "panxhë e shtazës" (kështu shkodranisht pas Kristoforidhit, po edhe toskërisht pas Leottit), përveç asaj edhe "shpullë, shuplakë, dackë" (edhe kjo në dialekt të Shkodrës: Junk, Cordignano); me këtë afrohet kuptimi "shqelm (në toskërishten, sipas Leottit). Ndërsa Junku *shputë* "çarape e shkurtër, gjurmashkë, shuall i këmbës" e dallon ortografikisht nga *shputë* "shpullë, shuplakë, dackë" (me kuptimet e para e shkruan *scpuut*, -a, po për "shuplakë" *scput*, -a), Cordignano nuk e ruan më një dallim të tillë, e besoj me të drejtë, mbasi në gegërishten çdo zanore e trupit të fjalës pas rënies së *ë-së* fundore dihet se zgjatet, e mbasi dallimi që bën Junku nuk përligjet me të dhënat e toskërishtes. 2) Në geg. lindore fjala rron me kuptimet "çarape e shkurtër, çarape e gjatë, shuall i këmbës" me trajtë të zgjeruar me sufiks -*kë* : *shputkë*, shumë *-a* "çarape e shkurtër, çarape e gjatë (në Gjakovë, sikundër kam nxjerrë para shumë vjetve nga një letër prej Gjakove); *shëputkë* (shkruar *sceputke*) "shuall i këmbës, thembër" te Bogdani, Cuneus proph. I. 79,3 (në atë vend të Biblës, Gjenezja 25,26, ku Vulgata ka *planta*, Kristoforidhi *thembrë*, e përkthimit gjermanisht të Biblës kanë *Ferse*). Në çdo rasë kjo dëshmi e Bogdanit tregon se balli i fjalës i të sotmes *shputë* në krye të herës ka qenë *shëp* - dhe se edhe vetëm për këtë arsye shihet se nuk ka sesi që kjo të ketë rrjedhur prej sllav. *stopa*, as atë here kur të mendonte njeriu një metatezë të sllav. *stopa* në \**spota*, ashtu si pas gjase ka menduar dhe Meyeri. 3) Edhe vetë nga krahasimi i *këputë-s* me *sh(ë)putë*, *sh(ë)putkë* arrihet në përfundimin që këtu kemi të bëjmë me kompozite, kompozite që përbëhen

nga prefiksi *kë-*, respektivisht *shë-*, e nga rrënjori *-putë* (*kë-putë*, *shë-putë*, *shë-put-kë*). Prefiksi *kë-është* poai që gjejmë p.sh. dhe te *i k-thiell-të* pranë it. — shq. *i thiel-m*, te *i k-theptë* "i thepisur", pranë *thep*, prefiksi *sh(ë)-* poai si te *sh-pall* pranë *për-pall* (khs. librin tim Studien zur alb. Etymologie und Wortbildung f. 22, 37, 83, ku gjinden dhe shembuj të tjerë): dhe *këputë* qëndron ndaj *shputë-s* poashtu si *k-pif* "shpif" ndaj *sh-pif*. Eksistenca e rrënjorit *-putë* vërtetohet më së miri me sinonimin e *shputë-s*, *put(ë)rë* "shuall, shuall i këmbës, çarape e shkurtër". *put(ë)rë* gjindet te Bashkimi, te Cordignano, te Tasi e te Leotti me kuptimin "shuall i këmbës"; Kristoforidhi jep (për Berat) kuptimin "panxhë e shtazës", Baronsha Godin e shënon këtë emër të gjerm. *Socke* "çarape e shkurtër". Dua të theksoj në këtë mes se pas një kuptimi miqësor të Zs. Faik Konica e Skënder Luarasi *putrë* në leksikon e njohur prej tyre do të thotë "shuall i këmbës së njeriut" (jo të shtazës, si e dëshmon Kristoforidhi për Berat). Shihet qartë kështu se kuptimet e fjalës ndryshojnë sipas krahinave. 4) Krahas me *shputë* "shuplakë, dackë" ekziston po me këtë kuptim edhe *shpullë* (në Mirditë; te Cordignano f. 200). Kjo së bashku me faktet e trajtuara më lart lejon këtë analizë të mëtejme: *shë-pu-t*, respektivisht *shë-pu-ll*. Po të pyesim tani për *zhovillimin* kuptimor të fjalëve që u përmendën më sipër (*kë-putë*, *shëputë*, *putërë*, *shpullë*), shohim se përsëriten kuptimet "shuall; goditje (shqelm, shuplakë)". Si pikënisje do marrë në çdo rasë "goditje" si kuptim primar. "Shuall" është pjcsa e rrafshët e trupit, ajo që është rrahur rrafsh (khs. lat. *planta* "shuall i këmbës", e cila pa dyshim shkon me fjalën *planus*). Përkundrazi kuptimi "çarape e shkurtër" ka dalë nga "shuall"; petkat shpeshherë e kanë emrin nga pjesët e trupit që mbulohen me to: *dorzë* (dorcë) "dorezë": *dorë*, *kamzë* "çarape e gjatë": *kambë*, gjerm. *Aermel* "mëngë": *Arm* "krah", frengj. *col* "qafë", po edhe "jakë" (e këmbës, e xhakëtës) etj.; dhe ai sufiks që do shkëputur te *dorzë* e te *kamzë*, na çfaqet dhe te *këpuçë*: *këpuçë* nga një \**këput-zë* (si *dorcë* nga *dor-zë*). Ky spjegim që u skicua këtu bëhet aq më afër meç, po të vërtetohet ekzistenca e një grupi foljor me kuptim bazë "rrah, godit, rrafshoj, i bie" edhe për shqipen. Një i tillë ekziston me të vërtetë: *këpus* "bie, rrah, godit, shkurttoj, pres, ndërpres, lodh, vjel një pemë". Këto kuptime pas Kristoforidhit, i cili përmbajtjen kuptimore të kësaj folje të shqipes e jep shkurt, po në mënyrë të plotë me gr. e re *κόπτω, διακόπτω*. Afërsisht kështu edhe Leotti: "rompere, spezzare, troncare, amputare, staccare, cogliere fiori, stancare". Kuptimi bazë "rrah, godit" që çfaqet në këtë mes, na del dhe nga disa shprehje që sjell Leotti, si p.sh. *i këputi me grushtin një goditje* "i dha me grusht një goditje" (fjalë për fjalë "i ra me grusht një goditje"). Përkundrazi kuptimet që jep G. Meyeri: "këpus, vjel një pemë, shkyej, jam i lodhët" nuk janë të plota. Lidhja që ka folja *këpus* me emrat *këputë*, *shputë*, *shpullë*, *putërë* na çon më tej për atë folje te një analizë *kë-pu-s*, \**kë-put-iō*, me *kë-* si prefiks (khs. më sipër *k-pif* pranë *sh-pif*). Morfologjikisht folja jonë hyn në kategorinë e foljeve sekundare të shqipes më *-t-iō* si *nxis*, *cys*, një kategori që e kam trajtuar shkurt në Mélanges linguistiques off. à M. Holger Pedersen 1937. f. 150 vv. Janë folje intensive e frekuentative, të cilat kanë dalë prej mbiemrash foljorë më *-t-*, poashtu sikundër foljet më *-nj* e më *-h*, që kanë të njëjtin funksion me ato, u përkasin mbiemrave foljorë më *-n-* e më *-h-*. Duke mbetur kështu brenda caqeve të shqipes, me ç'u shtjellua gjer këtu u tregua se kemi të bëjmë me një rrënjor foljor të shqipes *pu-* "rrah, godit." Spjegimi i shq. *këpus* nga një lat. \**carputio, carpo* (G. Meyer Fjal. et. 187v.) jo vetëm që bie në kundërshtim me domethëniet

që pamë më lart për këtë folje të shqipes, po nuk qëndron as nga pikëpamja e romanistikës, meqë një folje \**carputio* as nuk dëshmohet me traditën letrare të latinishtes as rindërtohet dot me anë të gjuhëvet romane. Më anë tjetër rrënjori foljor *pu-* që vërtetohet në këtë mes për shqipen, ekziston dhe në të tjera gjuhë indoeuropiane: lat. *pavio*, *pavire*, "rrah (tokën), shkel, shtyp" *pavimentum* "truall i shkelur, shtros, dysHEME", lat. e vj. *depuvio* "këpus, pres, shkurttoj" — sidomos ky kompozit i latinishtes piqet në kuptim fund e krye me kompozitin shqip *këpus* —, lit. *piāju*, *piauti* "pres, korr, ther" (khs. për këto folje Walde Pokorný Fjal. krah. i gjuhëvet indoeur. II 12, Trautmann, Fjal. baltosllav. 217). Tani jemi në gjendje të kuptojmë morfologjikisht më mirë edhe emrat e shqipes që u përmendën më sipër: *kë-pu-të*, *sh-pu-të* përmbajnë sufiks shqip *-të* (indoeur. *-tā*), ashtu si p.sh. fjalët *latë* e *botë* (Sh. Autorin, Stud. z. alb. Etymol. u. Wortbild. f. 7, 47), lit. *juōsta* "brez" etj.; te *sh-pu-llë* do veçuar sufiksi i shqipes *-llë*, ashtu si te *pillë* "macchina con cui si pettina il lino", një sufiks që i përgjigjet p.sh. sllav. *-lo* (sllav. kishtare *greblo* "lopatë barke, lugatë", khs. Brugmann Grundriss<sup>2</sup> II/1. f. 364 v., Autorin në veprën e cituar, f. 68 v.); *putërë* "shuall, panxhë e shtazës, gjurmashkë" (baza *pu-trë*) është formuar me sufiks shqip *-trë*, indoeur. *-trā*, *-trom*, ashtu si në gjuhët motra p.sh. lat. *aratum* "përmendë", gr. *πίπτρον* "ujë për të larë" (khs. Brugmann në vendin e cituar, f.342). — Sikundër shihet, në këtu gjurmuan një grup të tërë fjalësh të shqipes dhe mundëm e konstatuam që as *këpucë* as *këputë*, as *shputë*, e as *putërë* e *këpus* nuk janë të huaja; asnjëra nga këto fjalë nuk ka të bëjë me turq. *papuç* ose me sllav. *stopa* ose me një lat. \**carputio* të rindërtuar. Këto fjalë janë fjalë thjesht shqipe dhe të formuara me mjete të shqipes nga fondi i trashëguar i leksikut. Për të gjitha këto fjalë pra doli profecia e Schuchardtit që u citua më lart. Gjithë këtë grup nergut e trajtova në mënyrë të shtjelluar, meqë vetëm vështrimi sa më i plotë i fjalëve që lidhen midis tyre përbrenda shqipes jep mundësinë e një gjykimimi etimologjik të drejtë. Kur shohim sesi brezi i mëparmë, në radhët e të cilit ka pasur dijetarë aq të shënuar, arriti në përfundime që u pa se s'qëndrojnë dot, fajin për këtë e ka pasur pikërisht materiali i mangët. Do të shënoj si shtesë edhe këtë se shqyrtimi i izoluar i një fjale, i cili lë pas dore ekzistencën e fjalëve që janë të afra me të, mund të shpjerë në përfundime të shtrembëra. Kështu p.sh. po të marrim fjalët *këpucë* e *këputë* e t'i shikojmë në mënyrë të izoluar, pa marrë parasysh fjalët e afra me to, mund të na vente mendja t'i merrnim të dyja si huazime nga sllavishtja. *këpucë* nga një sllav. *kopytoča*, si na del në serbokr. *kōpica* "çarape, tozlluk", sllaven. *kopica* "çarape e shkurtër, thundër e këpucës", çek. (dialektore) *kopytō* "mbathje këmbësh nga lesh dhie, që arrin gjer te syri i këmbës", e *këputë* nga sllav. *kopyto* "thunder". Nga ana e fonetikës historike një spjegim i tillë bile edhe mund të kuptohej gjer diku, sepse në më të vjetrat huazime të shqipes prej sllavishtes tingulli sllav. *y* reflektohet në shqipen me *u*: *Bushtricë*, emër lumi, nga sllav. *Bystrica*; *karrutë* "koritë për fermentim të rrushit" nga sllav. *koryto* (Jokl, Indogerm. Forsch. 36, 152; Wedkiewicz, Roczn, Sl. 7, 126 v.). Vetë ekzistenca e formave *shëputë*, *putërë* e *këpus* ndërkaq vërteton se një i tillë interpretim izolues nuk ka si të qëndrojë më këmbë.

## II.

Fjalën e shqipes nis Meyeri (Fjal. etim. 310) e jep me kuptimet "filloj, stolis, gatit një njeri për rrugë", asaj i shton dhe mesoren *nisem* me kuptimet "stolisem, gatitem për një rrugë", dhe, pas hullisë së Miklosichit (Alban. Forschungen 3, 1871, f. 6), sheh aty një huazim prej aoristit

ἐκλίνωσα të gr. se re κινῶ, duke menduar se νᾶ κινήσης u reflektuaka në shqipen me të nisesh. Ndërkaq që në vendin e cituar të Fjalorit etimologjik të tij Meyeri çfaq dyshime; ai vren se me këte interpretim zhdukja e rrokjes së parë mbetet e paspiegueshme. Për këtë arsye në botimin e glossarit të Th. Kavaliotit që bëri 4 vjet pas Fjalorit etimologjik (Alban. Stud. 4, f. 21, Nr. 82 = Sitzungsberichte d. Wiener Akad. 132/12, 1895), Meyeri këtë spjegim e zëvendësoi me një tjetër: kjo folje rrjedh prej lat. *initium*. Pra edhe në këtë rasë do të kishim të bënim me një huazim. Ndërkaq as ky propozim nuk i qëndron kritikës. Një spjegim nga lat. *initium* edhe nga ana thjesht fonetike nuk ecën: kjo folje është edhe e gegërishtes edhe e toskërishtes. Kështu, po të ish burimi me të vërtetë lat. *initium*, në toskërishten refleksi i kësaj duhej të ishte me -r-, ashtu si shihet qartë te tosk. *armik* nga lat. *inimicus*, përkundrejt geg. *anmik*. Me fjalë të tjera: Ndrimi i n-së intervokalike në -r- (rotacizmi) në fjalë të këtij lloji është procesi më i vjetër, më i vjetër se ndrimi i zanores së patheksuar në ë përpara n-së e prandaj dhe më i vjetër se afereza e zanores nistore (khs. Puscariu, Dacoromania 3, 1924, 393). Shkurt pra, meqë spjegimi i tosk. *armik*, geg. *anmik* nga lat. *inimicus* është pa tjetër i drejtë e meqë ai i nis nga *initium* nga pikëpamja fonetike është në kundërshtim me të, kjo e dyta etimologji është evidentisht e padrejtë. Për gjykimin etimologjik të fjalës *nis* me rëndësi janë dhe rrethanat semantike. Përbajtja kuptimore e kësaj folje, me domethëniet që u cituan më lart sipas Meyerit, nuk është dhënë plotësisht, me gjithë se dhe fjalorët që kanë dalë pas Meyerit (Kristoforidhi, Bashkimi, Tasi, Godini, Cordignano, Leotti) në thelb pajtojnë me të dhënat e Meyerit. Një pasurim të njohurive tona në këtë mes na e jep një vend nga pjesa e re e Lahutës së Malcisë të P.G.J. Fishtës (Hylli i Dritës 10, 1934, f. 593) që cituam më lart: *me nisë kputat* "me thurë çarapet". Këtu kemi të bëjmë me një kuptim thjesht konkret "thur çarape", i cili na shpie në sferën e thjeshtë të zëjarisë shtëpiake, e njëkohësisht edhe me një përdorim frazeologjik, i cili sipas metodës së semantikës së re (khs. H. Sperber, Hyrje në semasiologji. 1923, f. 4), me anë të "konsociacionit", d.m.th. të lidhjes mbizotëronjëse, na lejon të çojmë një fjalë te rrethi gjuhësor nga i cili ka dalë, e kështu të konstatojmë thelbin e kuptimit të saj (khs. Leumann-Hofmann Gram. latine f. 24, J. B. Hofmann Indogerm. Forsch. 53, 1935, f. 187). Sikundër na tregon lidhja që u citua, sfera prej nga ka dalë kjo folje është zëjtaria shtëpiake shqiptare, dhe thelbi i kuptimit, kuptimi bazë i saj, është "thur çarape, thur". Atëhere kjo folje i përket rrënjës indoeur. *snēi, snē*, e cila në sllavishten përfaqësohet me *nitb* "fill, gjalmë", në latinishten me *neo, nere* "tjerr", në greqishten me *νή* "ai tjerr", në lituanishten me *nýtis* "kreher i tezgjahut, shpatëz", në letonishten me *snat* "dredh në fije të shlirta", në gjermanishten e lartë të vjetrën me *nājan* (gjerm. e sotme *nāhen* "me qepë") etj. (Khs. Walde-Pokorny, Fjal. krah. i gjuhëveve indoeur. 2, f. 694 v.). Nga pikëpamja e formës edhe *nis* do gjykuar ashtu si ato folje që u zunë ngoje te *kēpus*, d.m.th. se edhe kjo folje është një rrjedhojë (derivacion) më -io i një forme më -t (le të kemi parasysh në këtë mes sidomos lit. *nýtis*, sllav. e vj. *nitb*). Kuptimi bazë "thur çarape, thur" i fjalës shqipe qëndron ndaj atij të emrit *nitb* "fill, gjalmë" të sllavishtes krejt ashtu si gjerm. *stricken* "me thurë çarape" ndaj emrit përkatës *Strick* "litar, tërkuzë". Edhe gr. *πλέκω* "thur, dredh", po edhe "thur çarape", na ndriçon zhvillimin kuptimor (dredh-thur, thur çarape) që u ka kryer në shqipen. Për një burim të foljes së shqipes prej sllav. *nitb* as që mund të flitet, sa kohë që shihet qartë se zhvillimi kuptimor që ka kryer *nis* është fare i pavarur nga sllavishtja. Vërtet se në sllavishten nga *nitb*

është formuar një folje (p.sh. serbokroat. *nititi* "me rreshtue fijet në vegj", ashtu afërsisht dhe në rusishten); po kuptimi atje është shumë më i ngushtë nga ai që ka *nis* në shqipen; përveç kësaj, po të ishte burimi *nititi*, në shqipen prej asaj do të pritej një *\*nitis* (khs. *godis*, pjesorja *goditun* nga sllav. *goditi*, *koris* nga *koriti*, *grabis* nga *grabiti*). Mënfund — e kjo është vendimtare në pikëpamje fonetike — po të kishim të bënim me një huazim prej një teme të sllavishtes, ky në trajtat që s'janë të së tanishmes duhej të mbaronte me *-t*: khs. *i goditun*. Te *nis* përkundrazi *-s*-ja na del në gjithë trajtat e foljes. Përfundimi është që *nis* nuk buron as prej greqishtes së re, as prej latinishtes, as prej sllavishtes. Kemi të bëjmë me një fjalë të së endurit e të vegjve, dhe ngaqë të endurit në gjendjen e kulturave të lashta e të thjeshta bën pjesë në veprimtaritë shtëpiake të gruas, kemi një fjalë të zejtarisë shtëpiake. Kështu pra shq. *nis* i përket asaj sferë ku hyn p.sh. dhe lat. *ordior*. Edhe kjo fjalë ka dalë nga gjuha e endjes, dhe mori pastaj rrugën e kuptimit "filloj", krejt ashtu si *nis*-i i shqipes. Dhe në fakt P.A. Aldegheri në Fjalorin e tij latin-shqip *ordior* e ka përkthyer me *me fillue* e *me ja nisë*. Sesa piqet lat. *ordior*, bashkë me reflekset e saj në gjuhët romane, me shq. *nis* në punë të kuptimit, këtë na e tregon krahasimi i kuptimeve të tjera të fjalës *nis* me kuptimet që ka rum. *urzi* (refleksi i lat. *ordior*): *nis* sipas Ros-sit, Vocab. epir. -it. f. 902, 1 do të thotë dhe "themeloi, ndërtoj", e këto kuptime ka dhe rum. *urzi*. Sipas interpretimit që u dha këtu për *nis* ky afrim kuptimesh spiegotet si një konkordancë në formën e brendshme të këtyre dy fjalëve. Ndërkaq, një vërtetim që ky spjegim etimologjik është i drejtë na e jep tërthorazi dhe fjala *me fillue*, e cila është pjesërisht sinonime me *me nisë*. Ajo piqet me *nis* 1) në domethënien "zë fill (një punë), i hyj (një punë)", 2) në domethënien "marr një rrugë", te trajtat mesore *fillohem*, *nisem*. Ky kuptim i *fillohem* u mungon fjalorëve, po na del tani te një këngë popullore e Shoshtit botuar prej P. Donat Kurtit (Hylli i Dritës 12, 1936, 178, 181, 183). Shihet kështu se këto dy folje piqen me njëra-tjetrën në dy kuptime të rëndësishme. Ky fakt ndërkaq, i cili me interpretimet e gjertanishme të *nis*-it mbetet i pasqaruar, në dritën e spjegimit që jepet këtu bëhet i qartë menjëherë: sikundër që filloj i përket lat. *filum* "fill, pë", ashtu edhe *nis* i përket një rrënje shqipe *\*ni-t-* "fill, gjalmë, litar" të fondit të trashëguar. Paralelizmit të së dy foljeve i përgjigjet këtu paralelizmi kuptimor i temave nominale që përbëjnë bazën e tyre, në këtë mënyrë që për të dyja kuptimet që u dhanë më lart për këto folje pikënisja do kërkuar tek emrat. Për *filum* situata kuptimore mund të hetohet mirëfilli me latinishten ballkanike; ajo na lejon të nxjerrim një përfundim edhe për fjalën thjesht shqipe *\*ni-t-* që është paralele me të. Sikurse ka vërtetuar Capidani (Dacoromania 3, 1924, 759) me anën e përkimit të shq. *fill* "fillim" (*me zanë fill*) e të rum. dialektore *infierà* "me fillue" në punë të kuptimit, *filum* qysh në latinishten ballkanike ka dashur të thotë edhe "fillim". Në ç'raport qëndron tani shq. *fillohem* "nisem" ndaj *filloj* "nis, zë fill" e ndaj *fill* "pë", dhe *nisem* "marr një rrugë" ndaj *nis* "filloj, zë fill" (rrënjori *\*ni-t-*)? Këtu për foljet sinonime të shqipes duhet nisur nga *fille* "vijë, rresht, radhë", kuptime që i kanë Bashkimi me Cordignanon. Ky zhvillim kuptimi bëhet i qartë, po të sjellim ndër mend gr. e re  $\tau\acute{\alpha}\xi\delta\iota$  "udhëtim", në thelb "vijë", e cila shkon me  $\tau\acute{\alpha}\xi\varsigma$  "rresht, radhë". Te ky zhvillim i një kuptimi special na pasqyrohet të udhëtuarit në formë karvanesh, ku ruajtja e një rregulli të rreptë ishte e domosdoshme (khs. Jireček, Shteti e shoqëria në Serbinë mesjetare 2, f. 54 — Wiener Denkschr., Ph. — h. Kl. 56). Udhëtimi pra është — rreshtim (d.m.th. në vijë të karvanit); te aktivi "rreshtoj" (në këtë vijë karvani) i ka rrënjët kuptimi

transitiv "gatit, bëj gati, nisem". Edhe këtë kuptim të radhës, rreshtit lat. *filum*, baza e shq. *fille*, e ka pasur që në latinishten ballkanike, sikurse na tregon përkimi i shq. *fille* me rum. *a se prefira* "me shkue rresht, me shkue varg e vistër" (për këtë folje të rumanishtes khs. Candrea-Densusianu, Dict. etim. f. 97, Nr. 596); bile domethënia e neutrit shumësisë *fila* si "rresht, radhë" ka qenë e mbarë latinishtes vulgare, meqë është e gjallë dhe në gjuhët romane të Perëndimit (frgj. *file*, it., engad., katal. *fila* "rresht, radhë, varg"). Kur W. v. Wartburgu në artikullin e tij *filum* merr në shqyrtim këtë domethënie të gjuhëve romane (Fjal. etim. i frengjishtes 3, 539,2), mendon vërtet për një shumësisë neutër të latinishtes, po këtë spjegim më në fund anon ta zëvendësojë me një spjegim më të vjetër: frgj. *file* rrjedhë e foljes *filer* dhe përhapja e kuptimit "rresht, radhë" shkaktuar më vonë me luftrat e Rënësansës (kjo sipas Hatzfeld-Darmesteter-Thomas, Dict. gén.), do thënë se me këtë spjegim mbeten pa u marrë parasysh faktet e shqipes e të rumanishtes, pra të Lindjes, që u përmendën më sipër. Do shtuar në këtë mes se shq. *fille* "vijë, rresht, radhë" me fundorin -e që ka shihet qartë se është një shumësi i singularizuar me një kuptim në thelb kolektiv, sikundër kam treguar në IF 36, 1916-1917, 158 v. e në Litteris 4, 1927, 203 v. Në këtë mënyrë bash *fille* "rresht, vijë" vërteton spjegimin e parë të formave romane perëndimore nga ana e v. Wartburgut. Gjithsesi u pa se *nis* përmban një element të vendit, i cili u zhvillua në paralelizëm të gjërë me *filloj* që është e burimit të huaj.

### III.

Fjalën **ruazë** G. Meyeri (Fjal. etim. 370) e jep vetëm (pas Reinholdit) për dialektet shqiptare të Greqisë; ai propozon aty një spjegim që s'është bindëz aspak: fjala e shqipes paska rrjedhur nga një \**prllazë*, deminutivi i it. *perla*, dhe për këtë si paralele kinse fonetike prej dialekteve të Greqisë jep *pumbë* "pëllumb" nga *plmbë*, *puarë* "përrallë" nga *pllarë*. Ndërkaq këto "paralele" nuk arrijnë të mbështesin spjegimin e *ruazë*-s nga *perla*; te *pumbë* e te *puarë* p-ja nistore e fjalës bazë (lat. *palumbus*, *parabola*) ruhet, kurse duke iu mbajtur spjegimit të Meyerit për *ruazë*, zhdukja e p-së nistore mbetet e pakuptueshme. Prandaj me plot të drejtë Helbigu (J. Rum. Inst. Leipzig 10,65) e kundërshtoi etimologjinë e Meyerit, veçse s'e zëvendësoi atë me ndonjë tjetër. — J. G. v. Hahn (Alb. St. I, 159) vren se në pajtim me besimin popullor të shqiptarëve ruazat përdoren si hajmali, si mjet për të mbrojtur njeriun nga syri i keq. Për këtë në këto vjetet e fundit ka shkruar dhe R. Gjonedaj (Ora I, 1929, Nr. 28, për Tërbaç). Po të kemi parasysh këtë fakt të folklorit, atëhere spjegimi është dhënë vetvetiu. Shq. tosk. *ruazë* i përket foljes *ruaj*, krejt ashtu si gr. e vj. *φυλακτήριο* gr. e re *φυλακτήριο* "ruazë" që shkon me *φυλάττω* "ruaj". Kështu pra shq. tosk. *ruazë* si nga burimi etimologjik si nga funksioni semantik i saj është një mjet mbrojtës. Sufiksi -zë te *ruazë* nuk është sufiksi deminutiv -zë, po -zë-ja kolektive të cilën e kam konstatuar në Stud. z. alb. Etym. u. Wortb. f. 9 v., Ling.-kulturh. Unters. f. 89. Prandaj kjo do gjykuar ashtu si -zë te *trizë* "trini", te *një-ëz*, *njer-ëzi*, te *kallëz* "kallinj" që shkon me *kall* etj. Kështu *ruazë* fjalë për fjalë e në thelb është "varg mjetesh mbrojtëse, varg ruazash". Në bazë të kësaj analize morfologjike e duke u nisur nga ky kuptim primar kuptohen tani dhe domethëniet e fjalës që kanë dalë në shesh pas Fjalorit etimologjik të G. Meyerit. Kështu Leotti (Diz. alb.-it. 1937, f. 1212, I, 2) përveç "ruazë, sferëz, kokrrizë, kokërr ruzari" jep edhe *ruazë* (sumbullash) "varg" (kopsash) (una filza di bottoni). Pra

shihet se nga kuptimi bazë "varg ruazash" u zhvillua kuptimi "varg, rresht", sikurse m'anë tjetër "varg ruazash" dha "ruazë (=një kokërr ruazë). Kuptimi "varg, rresht" (tufë, shumicë) dëshmohet dhe me anë të literaturës dhe mund të ndiqet edhe në fillin e zhvillimit të tij; kështu Fan Noli në përkthimin e romanit "Kasollja" të Blasco Ibanezit (Boston 1920) ka më një vend *ruaza prej milingonjash* "tufa melingonash". Gjithë kuptimet e kësaj fjale që vumë re gjer këtu për toskërishten: "margaritar" (kështu edhe Leotti: *margaritarët, këto ruaza*), "kokërr ruzari; varg, rresht" tregojnë përveç kësaj se me *ruazë* (shkruar edhe *rruazë*, Leotti. v. Godin, D.-alb. Wb. 277 te fjala *Perle*) është identike një fjalë — me trajta të ndryshme — e gegërishtes të cilën G. Meyeri s'e njohu mirë, e trajtoi në mënyrë të mangët dhe në një tjetër vend, të ndryshëm nga ai i tosk. *ruazë* (Fjal. etim. 371 te fjala *rusë* "kurorë", për të cilën do të flitet më poshtë): *ruazë* "granelli piccoli di vario genere che s'infilzano a modo di rosario, e servono di ornamento (kështu te Cordignano, Diz. 174), *ruza* "grano della corona, e la corona stessa" (te Junku, Fjaluar 121), *rruzë* "vertebra, grano della corona stessa del rosario" (te Bashkimi Fjal. 386) e që te Rossi (Vocab. epir.-it. 1110) me trajtën *rrusa* e *ruz* "vertebra", *rruza-t* (shum.) "corona, filza di pallottoline che compogono il rosario" (Buseti, Vocab it.-alb. 271 te fjala *corona*). Kuptimi "kokërrizat e rruzares", si shumë (si e ka Cordignano) pajton më së miri me karakterin kolektiv të kësaj forme, të cilin e shtjelluam më sipër; këtë na e vërteton dhe një mënyrë përdorimi, për të cilën dëshmon Buseti në vendin e cituar: pas Busetit kjo fjalë është një plurale tantum. (Kjo mënyrë përdorimi nuk gjen vërtetim në burimet e tjera që u cituan gjer këtu, po gjen te një dëshmi e Bardhit që do të sjellim më poshtë). Po si qëndron puna tani me domethënien "rruza, peshku i kurrizit" (Rossi, Bashkimi), një domethënie e cila — të pakën në dukje — largohet aq shumë nga të tjerat? Kjo domethënie bëhet e kuptueshme, po të kemi parasysh që te Rossi e më parë te Bardhi gjindet shprehja e plotë: *ruz'e shpinës* (Rossi, Vocab. ep.-it. 1110,2), *ruzatë e shpinës* (Bardhi, Dict. 129 te *renes*). Këtu shohim pikësëpari në pikëpamje fonetike që *u-ja* e sotme e gegërishtes veriperëndimore në trup të fjalës është përfundimi i monoftongimit të *ue-së* origjinale që na ruhet te Bardhi, që pra ajo piqet më së miri me tosk. *ruazë*. Semantikisht lidhja *ruz'e shpinës*, më parë *ruzatë e shpinës* "rruza, peshku i kurrizit", nuk është gjë tjetër veçse një kalk (calque linguistique) nga ital. *filo delle reni*, duke dëshmuar kështu për geg. *ruazë* poatë kuptim "rresht, radhë" (=ital. filo) që vumë re më lart për *ruazë-n* e toskërishtes. Me interpretimin *renes* që ka Bardhi ky shumë latin do marrë si "kërdhokull" (jo si "veshka"); ky kuptim gjindet që në latinishten dhe vazhdon të jetë dhe në refleksin *reni* të italishtes. Me kohë, nga lidhja *ruze e shpinës* = *filo delle reni* u shkëput, u zbërthye *ruze', ruz'*, e ky emër vetë mori atë domethënie që në krye të herës kish kuptim për mbarë lidhjen si të tillë. Procesi i shkëputjes, i zbërthimit është mjaft i shpeshtë në historinë e fjalëve; po përmend si shembëll frgj. *bas* "çarape", e cila u shkëput nga lidhja origjinale (e frengj. së vjetër) *bas de chausses* "pjesa e poshtme e brekëve të gjata" (Gamillscheg, Fjal. etim i gju. fr. 85). Kuptimi "kurorë" është sekundar; ai nuk është veçse një zhvillim i veçantë i kuptimit "rresht, radhë, varg" (varg ruazash, margaritarësh"), sikundër shihet qartë nga përkthimet e fjalës te Junku e te Buseti. Nga pikëpamja morfologjike është për të vënë re se dëshmia e moçme e Bardhit: *ruzatë* (shum.) e *shpinësë* që u citua më lart, po të krahasohet me modernen *ruz'e shpinës* (te Rossi), është në gjendje të vërtetë mendimin e Busetit që këtu kemi të bëjmë me një plurale tantum. Shihet kështu se përdorimi i fjalës nuk është kudo një-

soj. Përdorimi si shumë dëshmohet edhe gjetkë: *kokrra rruzash* "ruazat e rruzares" (Don Nd. Suma, Leka 7, 1935, 208), pra me *-ash* të shumësit. Kur shohim se disa nga fjalorët e cituar të gegërishtes (Bashkimi, Rossi) bashkë me autorin që sapo u përmend, këtë fjalë e japin dhe me *rr-*, nuk do të harrojmë se këtë tingull nistor e gjetëm më lart dhe në një pjesë të burimeve të toskërishtes. Spjegimi që u dha këtu për këtë fjalë na dëfton se vetëm *r-*ja e thjeshtë përligjet nga ana etimologjike. Te trajtat me *rr-* nistore kemi të bëjmë me një shndrim eufemistik, shndrim i zakonshëm në fjalët e sferës "orëzezë" të frikës. Le të kujtojmë për krabasim gjerm. *Dei xl, Toi xl, Denker* për *Teufel* "djall", çek. (më e vjetër) *dias*, sot *dās* "djall" pranë *d'abel*, pol. *djaszek* "djall" në vend të *djabel* (Berneker, Fjal. et. sllav I. 199). Meyeri këto trajta të gegërishtes nuk i njihte veçse pjesërisht e në mënyrë jo të plotë. Me gjith'atë trajtat e Rossit e të Bardhit *ruz'e shpinës, ruezatë e shpinësë*, që u përmendën më lart, ai i dinte, dhe, sikundër u tha, i trajtonte veç nga tosk. *ruazë*, te fjala *rusë* "kurorë", të cilën donte ta nxirte prej serb. *rusa* "trëndafil". Në këtë mënyrë kuptimi sekundar i kurorës merret e vihet në krye. Përveç kësaj shqyrtimi i përgjithshëm i trajtave e i përdorimit që u bë këtu besojmë të ketë treguar sa duhet, që të gjithë këta emra nuk kanë të bëjnë asgjë me "trëndafil" e me serbokr. *rusa*. Kundra një mendimi të tillë flasin dhe kuptimi i fjalës dhe tingujt (geg. *-u-* e trupit të fjalës nga *-ue-*, *z-*ja origjinale, jo *s*, khs. dëshminë e Bardhit). Një shqyrtim të shkurtër kërkon ndërkaq dhe tingulli *s* në trajtën (o më mirë të themi) në trajtën e paqenë *rusë* të Meyerit e *rrus* të Rossit. Aty *s-*ja në gegërishten u përltua në fund fjale (pas zhdrukjes së rregullt të *-e-së* në gegërishten). Meyeri trajtën *rusë* "kurorë" e mori nga fjalori i parë i Rossit (Vocab. it.-ep. 1866, f. 139 te fjala *corona*); kjo aty na del me trajtën *ruse*. Meyeri këtë sipas zakonit të tij (khs. Helbig, Jb. d. Rum. Lpz. 10, 47, Autori IF 36, 1916-17, 110) e dha arbitrarisht me *rusë*. Në këtë mes as ka një bazë për ekzistencën e trajtës *ruse* (kjo nuk përsëritet më në vepërën e mëpastajme të Rossit Vocab. ep.-it., as nuk del nëpër të tjerët fjalorë të gegërishtes), as është *rusë* një formë fonetike korekte. Korekte është vetëm *rus*, meqë *z-*ja ka dhënë në gegërishten *s* në fund të fjalës. Kështu pra historikisht do shkruar *ruetzë, ruzë*, fonetikisht *rus*. Trajta *rusë* përkundrazi është një mixtum compositum, i cili nuk është as historik as fonetik. Meyeri edhe trajtat *ruz'e shpinës, ruezatë e shpinësë* deshi t'i vendonte bashkë me trajtën e paqenë *rusë* e me serbokr. *rusa* "trëndafil". Veçse këtë ai e bëri me një farë dyshimi. Ky vendim fjalësh së bashku nga ana e Meyerit nuk ka më nevojë të kundërshtohet, sapo që me dëshminë e tosk. *ruazë* vërtetohet më së miri se fjala në trup të saj ka pasur *-ue-*. Shihet kështu se tosk. *ruazë* geg. *ruetzë, ruzë, rus* me të gjitha kuptimet që kanë janë identike. M'anë tjetër fjala *ruzare*, të cilën Meyeri (Fjal. etim. 371) e përfshin te *rusë* (më drejt: *ruzë, rus*), nuk ka të bëjë aspak me këtë grup fjalësh të gegërishtes, e përgjithësisht të shqipes, që u shqyrtua këtu. *ruzare* është një huazim nga ital. *rosario*, sikundër e vuri në dukje Meyeri vetë e pas tij Helbigu (Jb. d. Rum. Inst. Lpz. 10, 129). Prandaj edhe vetë pas mendimit të Meyerit kjo fjalë nuk duhej bashkuar më një me artikullin *rusë*. Pas sa u shtjellua më sipër, te njëra rasë (tosk. *ruazë* — geg. *ruetzë, ruzë, rus*) kemi të bëjmë me emra që janë formuar me mjetet e shqipes, e te *ruzare* me një huazim prej italishtes; në rasën e parë me fjalë, të cilat në analizë të fundit lidhen me disa përfytyrime e doke të bestytnive popullore, në të dytën me një huazim të fushës kishtare. Do shënuar në këtë mes që përhapja e rruzares në Perëndim nuk ka filluar më parë se në shekullin e 13. (Weigand-Hirt, Fjalori gjerman 2 606).

U fol më lart për konkordancën e shq. *ruazë* etj. me gr. **φυλακτήριον** në punë të formës së brendshme të fjalës. Si duhet kuptuar kjo konkordancë? A kemi të bëjmë me një kalk përkthimi nga ana e shqipes? Kjo s'ka të gjarë. Përdorimi i një ruaze me qëllim apotropeik është i përhapur kudo; e gjejmë p.sh. që tek Indasit e moçëm (Schrader-Nehring, *Reallexikon* 2, 159), e poashtu edhe sot në Indi (Seligmann, *Syri* i keq 2,224), në mbarë Levanten (246), në Ungari, në Afrikë lindore (poaty 101) e gjetkë. Ky përdorim m'anë tjetër edhe në Europë shkon gjer në kohët e lashta, duke u çfaqur p.sh. dhe te Gjermanët e vjetër (Schrader-Nehring, *vepra e cituar* I, 47). Përveç kësaj, përkimi semantik midis shq. *ruazë*, *ruezë* e gr. **φυλακτήριον** përfshin vetëm përfytyrimin e mbrojtjes e të primit (të largimit të së keqes) që përbën bazën e tij, po nuk shtrihet gjer në zhvillimet e mëtejme të kuptimit. Në greqishten fjalë **φυλακτήριον** mbeti te domethënia "mjet mbrojtës, hajmali", në shqipen *ruaza* etj. që i përgjigjet asaj arriti dhe në domethënien "varg ruazash", e më tej dhe te "ruazë, margaritar; rresht, radhë, varg, tufë, kurorë, rruzë, peshku i kurrizit" që pas shtjellimeve që u bënë më lart kanë dalë nga "varg ruazash", duke shërbyer për kuptimin e fundit të peshkut të kurrizit si model italishtja.

(Përktheu nga gjermanishtja E. Ç.)

### R é s u m é

## HISTOIRE DES MOTS COMME HISTOIRE DE CULTURE DANS LE DOMAINE DE L'ALBANAIS

*Dans cet article qui fait part de l'héritage scientifique de N. Jokl, l'éminent albaniste de l'Université de Vienne, est reprise une idée de H. Schuchardt, selon laquelle on devra restituer un jour à l'albanais des mots considérés jadis comme des emprunts. Cette idée est élargie et approfondie ici dans le sens que cette restitution d'éléments autochtones dépend notamment aussi d'une connaissance plus exacte du lexique, des nuances sémantiques des mots, de la phraséologie, aussi bien que des faits du folklore.*

*Trois mots étudiés dans cet article confirment cette thèse importante au point de vue de la méthode.*

*La désignation du soulier, këpucë, n'est pas un emprunt au turc papuç, papuç "pantofle". Ce nom fait part d'un groupe de mots hérités, tels que këputë "bas (de chausses) couvrant seulement le pied jusqu' à la cheville", shputë même sens et "plante du pied; soufflet (coup)", le diminutif shëputkë (P. Bogdani 1683) "planta, talon", putërë "patte de l'animal, plante du pied de l'homme; bas couvrant le pied jusqu'à la cheville" et shpullë "soufflet (coup)", aussi bien que le verbe këpus "couper, trancher, battre", dont la dérivation d'un lat. \*carputio inexistant est impossible. L'analyse morphologique dégage pour ces mots albanais comme forme de base un radical pu-, en rattachant ceux-ci au lat. pavio pavire "battre la terre pour l'aplanir; niveler" pavimentum "terre battue; pavé, dallage", depuvio "battre"; këpucë de këput-zë, forme à suffixe -zë.*

*Le verbe nis "préparer, arranger; parer, pourvoir, munir, fournir de; entamer (des mets)", nisem "se parer, s'arranger pour le voyage, partir", ne provient ni du néo-gr. **κινῶ ἐκίνησα** "mouvoir; partir, venir", ni du lat. initium, qui aurait abouti en tosqe à une forme à rhotacisme. Des données nouvelles provenant des dialectes emmènent à "tricoter" comme pré-*

mier sens du mot. Dès lors, nis appartient à la racine indo-eur. snēi- snē-, où rentrent entre autres le sl. nitъ "fil, corde", le lat. neo. nere "filer; tisser, entrelacer", le gr. νῆν "filer", le lit. nýtis "peigne de tisserand", le letton snat "tordre de façon lâche, filer", l'all. nähen "coudre". Le développement sémantique de nis "commencer" et nisem "s'arranger pour le voyage, partir" par rapport au sens primitif de "tricoter", est comparable à celui de filloj "commencer" et fillohem "se mettre en route, partir", qui proviennent en dernière analyse du lat. filum. A confronter aussi le néo-gr. ταξίδι "voyage", qui se rattache à τάξις "ordre, régularité; file, rangée." Dans tous ces mots se reflète le voyage en forme de caravanes.

Le nom ruazë "grain enfilé, perle" est de même un mot des sources autochtones, non pas un emprunt à l'it. perla. Comme le gr. φυλακτήριον "amulette, talisman" appartient à φυλάττω "garder, conserver", tout aussi ruazë se rattache à ruaj "garder, faire la garde, être en guet." En Albanie comme dans d'autres pays les perles servent dans les croyances populaires comme amulettes, comme moyens qui préservent du mauvais oeil. Le suffixe-zë est de caractère collectif (non diminutif), ruazë désignant ainsi à l'origine un collier de perles, un chapelet. La forme du guègue qui correspond au tosqe ruazë est ruzë "granelli piccoli di vario genere che s'infiltrano a modo di rosario, e servono di ornamento", ruz-a "grano della corona, e la corona stessa", chez G. Meyer rusë "couronne", considéré à tort comme un emprunt au serbochr. rusa "rose". Ce ruzë remonte à ruezë qui répond exactement à ruazë du dialecte tosqe. La forme origininaire du guègue se retrouve dans le Dictionarium latino-epiroticum de Fr. Blanchus (1635), dans l'expression ruezatë e shpinesë "renes", dans le sens de "lombes, hanche". Il s'agit ici d'un calque linguistique de l'it. filo delle reni. On ne peut pas dire la même chose de ruazë par rapport au gr. φυλακτήριον, le terme albanais par l'extension même de ses significations étant indépendant du mot grec. Quant à ruzare "rosaire", ce mot étant un emprunt à l'it. rosario, n'a rien à faire avec ruazë ruezë ruzë analysés dans cette étude.